

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kosovë/ Kuvendi tenton sot të dalë nga bllokada, rifillon procesi i konstituimit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/kosove-kuvendi-tenton-sot-te-dale-nga-bllokada-rifillo-n-procesi-i-konstit-i584865
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 06:27:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 06:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8a08217634c99f9b1b7e0cfd4e66d1846a22399bdb966239d1727b83b2f265a
TEKSTI	ee856ce86b69b51c7c8f8abb3447f008a988203700f1139528640ad5de3858ad
PAMJA	636e0500afb7316fe0a7fa199162bc5483eeae8ba4dc2e081326c95bfc7fdee5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d5439c92c69d6de322db4fb21b82687abf3666c3b6827dc285aff6134a7debdd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d5439c92c69d6de322db4fb21b82687abf3666c3b6827dc285aff6134a7debdd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Shperthimi në karburantin të "Bryll", reagon Policia: Tre punonjes të plagosur jashtë rrezikut për jetënKaos në aeroportet britanike, mbi 600 fluturime anulohen pas defektit në sistemin e kontrol

Kosovë/ Kuvendi tenton sot të dalë nga bllokada, rifillon procesi i konstituimit

9 Shtator 2026, 08:55Rajoni TEMA



Kosovë/ Kuvendi tenton sot të dalë nga bllokada, rifillon procesi

Kuvendi i Kosovës pritet të rifillojë sot (9 shtator) procesin e konstituimit, pas më shumë se një muaji bllokadë institucionale. Seanca e vazhdimit është caktuar për në orën 11:00, ndërsa në qendër të saj do të jetë sigurimi i votave për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Pjesëmarrjen në seancë e kanë konfirmuar Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Ndërkohë, Aleanca ka njoftuar se do ta bojkotojë seancën. Pjesëmarrja e LVV-së konsiderohet vendimtare për vijimin e procesit, pasi subjekti që doli i pari në zgjedhjet e 7 qershorit ka numrin më të madh të deputetëve dhe mbetet aktori kryesor në përcaktimin e udhëheqjes së Kuvendit.

Kryetari i LVV-së dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka deklaruar më herët se partia e tij nuk ka arritur marrëveshje me subjektet e tjera politike për përbërjen e udhëheqjes së Kuvendit. Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka konfirmuar se deputetët e kësaj partie do të marrin pjesë në seancën e së mërkurës. Ai ka theksuar se konstituimi i Kuvendit është i domosdoshëm dhe se Kosova duhet të ketë institucione funksionale sa më shpejt. PDK-ja ka bërë të ditur gjithashtu se do të propozojë Vlora Çitakun për postin e nënkryetares së Kuvendit, duke insistuar se kandidatura e saj është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar.

Edhe LDK-ja ka konfirmuar pjesëmarrjen. Deputetja Jehona Lushtaku ka deklaruar se grupi parlamentar do të jetë i pranishëm dhe do të kontribuojë në përfundimin e procesit të konstituimit. Ndërkohë, Aleanca ka vendosur të mos marrë pjesë në seancën e sotme. Kryetari i saj, Ardian Gjini, ka deklaruar se shumica dërrmuese e deputetëve dhe anëtarëve të kryesisë kanë mbështetur vendimin për bojkot. Sipas tij, pjesëmarrja do të nënkuptonte legjitimitimin e asaj që ai e cilësoi si shkelje të vazhdueshme të Kushtetutës nga partia fituese e zgjedhjeve. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë u mbajtën më 7 qershor, ndërsa rezultatet u certifikuan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 8 korrik.

Sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi duhej të konstituohet brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve, me afat përfundimtar më 7 gusht. Seanca e parë e legjislaturës së re u thirr më 6 gusht, por për shkak të pamundësisë për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve, procesi mbeti i papërfunduar. Seanca vazhdoi më 8 gusht nën drejtimin e Avni Deharit, por edhe atëherë nuk pati rezultat. Pas disa javësh bllokadë dhe presioni politik, më 4 shtator Dehari njoftoi se vazhdimi i seancës do të mbahej më 9 shtator.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[A do të mbyllet konstituimi i Kuvendit të Kosovës më 9 shtator?](#)

21:40 Rajoni

[Funerali me nderime shtetërore i Mlladiç, Mbretëria e Bashkuar thërret të Ngarkuarin me Punë të Serbisë](#)

19:30 Rajoni / 1 koment

[Kallas i dërgon mesazh Serbisë: Lavdërimi i një kriminelit lufte është fyerje për viktimat](#)

17:20 Rajoni / 5 komente

[Von der Leyen dhe Costa: Pamjet nga varrimi i Mlladiçit në Beograd ishin tronditëse](#)

11:30 Rajoni / 17 komente

[Dje Beogradi u shndërrua në vend pelegrinazhi për të nderuar një turp dhe krim me përmasa rrëqethëse](#)

10:30 Rajoni / 16 komente

[Gazi lotsjellës në Kuvendin e Kosovës në vitin 2018, Ministri i Brendshëm Xhelal Sveçla dënohet me një vit burg](#)

10:00 Rajoni / 20 komente

[1,000 euro për çdo të porsalindur, Bashkia greke miraton skemën për të luftuar rënien demografike](#)

22:40 Rajoni / 4 komente

[Ratko Mladiq u përcoll me ceremoni shtetërore, BE dënon glorifikimin e kriminelëve të luftës](#)

20:30 Rajoni / 3 komente

[U arrestua nën akuzat për spiunazh për llogari të Serbisë, Fatmir Sheholli del para gjykatës në Kosovë: Jam i pafajshëm!](#)

18:30 Rajoni / 16 komente

[Vuçiç përgatit rokadën/ I kërkohet zyrtarisht që të shpërndajë parlamentin, do kandidojë për kryeministër](#)

18:05 Rajoni

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika / 48 komente

[Përplasja mes biznesmenëve për pronën në Palasë, Filip Ça...](#)

10:10 Sociale / 25 komente

[FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...](#)

Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...

14:50 Politika / 10 komente

Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...

19:40 Politika / 74 komente

Blog Tema

“Respekte”, z. Korrupsion!

22:30 Blog

Përse dështoi Reforma në Drejtësi

17:10 Blog / 30 komente

Pelegrinazhi amerikan i Berishës i duhet vetëm Berishës

16:24 Blog

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.



TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by